

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM  
PER REGJISTRIM PERSONI JURIDIK

Sot me 21 /12/2001 perpara meje *Regjise Sollaku* Gjyqtare prane Gjykates se rrethit Tirane, u paraqit Z.Engjell Burimi, ne cilesine e Presidentit te shoqerise "S.K. BESA" SHA, i cili me paraqiti kerkesen per regjistrim ne Regjistrin Tregtar te kesaj shoqerie dhe dokumentet perkatese, nga te cilet

KONSTATOVA

Shoqeria "S.K.BESA" SHA eshte themeluar ne Tirane, me date 11.12.2001 nga aksioneret themelues Engjell Burimi, Shpetim Bizhdili dhe Bashkia Kavaje.

- Shoqeria ka si objekt te aktivitetit:
  - 1. Veprimtari ne fushen e zhvillimit te aktivitetit te futbollit ne Klubin e Futbollit "BESA" duke perfshire ketu jo vetem ekipin e pare por dhe ekipet e moshave me te reja "Sistem Zinxhir"
  - 2. Shitja dhe blerja e lojtareve ne funksion te arritjes se qellimit per te cilen eshte krijuar kjo shoqeri.
  - 3. Kontraktimi per te drejten televizive me te gjitha personat juridik dhe fizik brenda dhe jashte vendit te ndeshjeve te futbollit dhe te cdo aktiviteti tjeter sportiv qe do te kryeje shoqeria ne funksion te aritjes se qellimit per te cilen eshte krijuar, duke respektur njekohesisht kushtet e vendosura per transmetim radio televiziv nga legjislacioni ne fuqi dhe regullat e e vendosura nga F.SH.F-ja per kete qellim.
  - 4. Per arritjen e qellimit te saj shoqeria mund te marre dhe te jape pasuri te luajteshme dhe te paluajteshme me qira ose ne cdo forme tjeter perdorimi.
  - 5. Kryerjen e aktiviteteve ekonomike qe kane te bejne me marketingun e se drejtes radio-televizive dhe atyre ne fushen e reklamave, te manaxhimit te reklamave, te manaxhimit te lojtareve brenda dhe jashte vendit, duke respektuar rregullat e vendosura per kete qellim nga F.SH.F.
  - 6. Blerje me qellim shitjeje si dhe cdo veprimtari tjeter tregtare qe eshte ne pajtim me qellimin e krijimit te shoqerise si import- eksport dhe shitje te materialeve dhe artikujve sportive dhe atyre ne funksion te terreneve sportive.
  - 7. Shoqeria per arritjen e qellimit te saj, kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme duke perfshire edhe blerjen e aksioneve ne shoqeri dhe ndermarje te tjera.
- Emertimi i shoqerise do te jete "S.K. BESA" SHA.
  - Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i percaktuar.
  - Selia e shoqerise eshte ne adrese: Stadiumi "BESA", Lagjia n.2, Kavaje.
  - Kapitali shoqeror eshte leke 2.000.000 (dymilione) dhe i nenshkruar e derdhur plotesisht nga aksioneret themelues ne keto raporte:

- Engjell Burimi – 34% te aksioneve ose ne vlere 680.000 leke
- Shpetim Bizhdili – 33% te aksioneve ose ne vlere 660.000 leke
- Bashkia Kavaje 33% te aksioneve ose ne vlere 660.000 leke

100% te aksioneve ose ne vlere 2.000.000 leke

- Drejtor i shoqerise eshte Z. Engjell Burimi.
- Keshilli Mbikqyres i shoqerise perbehet nga zoterinjte: Agron Harizi, Fatmir Efica dhe Islam Veliu.

### PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit Nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit Nr. 7667, dt. 28.02.2003 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitete qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare";

### VENDOSA

Regjistrimin ne Regjistrin Tregtar te shoqerise "S.K.BESA" SHA me aksionere themelues Engjell Burimi, Shpetim Bizhdili dhe Bashkia Kavaje.

- Shoqeria ka si objekt te aktivitetit:
  1. Veprimtari ne fushen e zhvillimit te aktivitetit te futbollit ne Klubin e Futbollit "BESA" duke perfshire ketu jo vetem ekipin e pare por dhe ekipet e moshave me te reja "Sistem Zinxhir"
  2. Shitja dhe blerja e lojtareve ne funksion te arritjes se qellimit per te cilen eshte krijuar kjo shoqeri.
  3. Kontraktimi per te drejten televizive me te gjitha personat juridik dhe fizik brenda dhe jashte vendit te ndeshjeve te futbollit dhe te cdo aktiviteti tjeter sportiv qe do te kryeje shoqeria ne funksion te aritjes se qellimit per te cilen eshte krijuar, duke respektur njekohesisht kushtet e vendosura per transmetim radio televiziv nga legjislacioni ne fuqi dhe rregullat e e vendosura nga F.SH.F-ja per kete qellim.
  4. Per arritjen e qellimit te saj shoqeria mund te marre dhe te jape pasuri te luajteshme dhe te paluajteshme me qira ose ne cdo forme tjeter perdorimi.
  5. Kryerjen e aktiviteteve ekonomike qe kane te bejne me marketingun e se drejtes radio-tevizive dhe atyre ne fushen e reklamave, te manaxhimit te reklamave, te manaxhimit te lojtareve brenda dhe jashte vendit, duke respektuar rregullat e vendosura per kete qellim nga F.SH.F.
  6. Blerje me qellim shitjeje si dhe cdo veprimtari tjeter tregtare qe eshte ne pajtim me qellimin e krijimit te shoqerise si import- eksport dhe shitje te materialeve dhe artikujve sportive dhe atyre ne funksion te terreneve sportive.
  7. Shoqeria per arritjen e qellimit te saj, kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme duke perfshire edhe blerjen e aksioneve ne shoqeri dhe ndermarje te tjera.
- Emertimi i shoqerise do te jete "S.K. BESA" SHA.
- Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i percaktuar.

- Selia e shoqerise eshte ne adrese: Stadiumi "BESA", Lagjia n.2, Kavaje.
- Kapitali shoqeror eshte leke 2.000.000 (dymilione) dhe i nenshkruar e derdhur plotesisht nga aksioneret themelues ne keto raporte:
 

- Engjell Burimi –	34% te aksioneve ose ne vlere 680.000 leke
- Shpetim Bizhdili –	33% te aksioneve ose ne vlere 660.000 leke
- Bashkia Kavaje	33% te aksioneve ose ne vlere 660.000 leke
100% te aksioneve ose ne vlere 2.000.000 leke	
- Drejtor i shoqerise eshte Z. Engjell Burimi.
- Keshilli Mbikqyres i shoqerise perbehet nga zoterinjte: Agron Harizi, Fatmir Efica dhe Islam Veliu.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim brenda afateve ligjore.

**GJYQTARE**

*Agjencja e Gjykatave*  
*Agjencja e Gjykatave*

# AKT THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME "S.K. BESA" SH.A

Me cilesine e aksionereve themelues :

1. **ENGJELL BURIMI**, i biri Bashkimit dhe i Drites, lindur ne Tirane me 05.07.1955 dhe banues ne Tirane me adrese: Njesia Nr. 5 Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" Apartamenti 7/1, me zotesi plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes n.
2. **SHPETIM BIZHDILI**, i biri i Banushit dhe i Qerimes i lindur ne Kavaje me 26.10.1963 dhe banues ne Kavaje me adrese Lagjia Nr. 5, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes n.
3. **BASHKIA KAVAJE**, perfaqesuar nga Kryetari i saj Z. Islam VELIU, i biri Brahimit datelindjes 16.12.1953, lindur dhe banues ne Kavaje, ne Lagjen nr 5, RR."Kajo Karafili".

Duke u nisur nga Vendimi i dates 21.10.2001 i Asamblese se Jashtezakonshme te klubit te Futbollit "BESA", vendim i cili ka vendosur shnderrimin e Klubit te Futbollit "BESA" ne Shoqeri Tregtare te lloit aksionere (sh.a), ligji nr.8650, date 28.07.2000, "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9114, Dt 28.03.1996 "Per Sportin" si dhe ne zbatim te te gjitha kritereve te percaktuara ne Udhezimin Nr. 9 dt. 12.09.1996 te Ministrit te Kultures, si dhe duke u nisur nga fakti qe brenda afatit 30 ditor te percaktuar nga ana e kesaj Ministrie per pjesmarjen e personave te tjere fizik ose juridik ne procesin e themelimit te kesaj shoqerie, si themelues te shoqeris tregtare "S.K.BESA"Sh.a, kane vendosur sa me poshte:

## Neni 1

Te themelojne Shoqerine tregtare "S.K. BESA"Sh.a, ne formen e nje Shoqerie anonime pa oferte publike Sh.a. Ne te gjitha aktet qe do te nxjerre shoqeria kundrejtuar te treteve si dhe ne te gjitha aktet e brendeshme te saje, do te shenohet detyrimisht emri "S.K. BESA" Sh.a.

## Neni 2

### *Qellimi i Krijimit te Shoqerise*

Qellimi i krijimit te kesaj Shoqerie eshte funksionimi i Klubit te Futbollit "BESA" si Shoqeri tregtare te llojit Anonime duke patur si qellim fitimin, nepermjet realizimit te veprimtarive ekonomike teresisht me karakter sportiv, ne perputhje te plote me vendimin e Asamblese se Klubit te Futbollit "BESA", te dates ....., si dhe ligjit 8650, date 28.07.2000 "Per Disa Shtesa dhe Ndryshime ne Ligjin nr.8114, date 28.03.2000 "Per Sportin", dhe ne perputhje te plote me Udhezimin e Ministrise se Kultures nr.9, date 12.09.2000 dhe rregullat e vendosura ne aktet e brendeshme te FSHF.

Veprimtaria e kesaj shoqerie do te jete thellesisht me karakter ekonomik dhe qellim fitimprures.

Si qellim final Shoqeria do te kete realizimin e veprimtarise ekonomike dhe nepermjet saj do te synoje arritjen e veprimtarise sportive te Klubit te Futbollit "BESA" si brenda ashtu dhe jashte vendit.

## Neni 3



### **Emri i Shoqerise**

Shoqëria do të ruaje me fanatizem emrin dhe stemen e Klubit të Futbollit "BESA" dhe asnjehere nuk do ta ndryshojë atë.

Ky emër do të mbetet i tillë edhe në rast të transferimit të titullit të aksioneve të kësaj shoqërie, në persona të tretë.

Emri dhe stema e Shoqërisë në asnjë rast nuk nxirren në likuidim, në rast të falimentimit apo të shpërberjes së Shoqërisë. Në një rast të tillë ato kthehen në pronësi të Bashkisë Kavajë e cila ka detyrimin të ruajë traditën e këtyre simboleve.

Perfaqësimi i emrit dhe stemes së Klubit të Futbollit "BESA", do të bëhet në formën e zotërimit të një aksioni, i cili është kontribut i këtij institucioni dhe është i barasvlefshëm me emrin dhe stemen e Klubit. Ky kontribut nuk mund të shitet, dhurohet apo të ndryshojë pronësinë.

Shoqëria ka të drejtë të përdorë emrin dhe stemen e Klubit për qëllime sportive ekonomike sipas vendimeve të organeve drejtuese të sajë.

Perfaqësimi në shoqëri i emrit dhe stemes së Klubit do të realizohet nga perfaqësuesi i Bashkisë Kavajë, që do të jetë një perfaqësim vetëm sipas përcaktimit të bërë me sipër dhe jo një perfaqësim që lind detyrime për aksionerët themelues të shoqërisë konform ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

Pjesa e aksioneve të emrit dhe stemes së Klubit duke qenë se nuk mërzë pjesë në qarkullimin civil dhe në realizimin e aktivitetit ekonomik të shoqërisë nuk do të llogaritet si aksion me të drejtë vote dhe si i tillë ky kontribut është një kontribut që për më tepër nuk llogaritet në ndarjen e fitimeve.

### **Neni 4**

#### **Objekt i Veprimtarisë së kësaj Shoqërie do të jetë:**

1. Veprimtari në fushën e zhvillimit të aktivitetit të futbollit në Klubin e Futbollit "BESA" duke përfshirë këtu jo vetëm ekipin e parë por dhe ekipet e moshave me të reja "Sistem Zinxhir"
2. Shitja dhe blerja e lojtarëve në funksion të arritjes së qëllimit për të cilin është krijuar kjo shoqëri.
3. Kontraktimi për të drejtën televizive me të gjithë personat juridikë dhe fizikë brenda dhe jashtë vendit të ndeshjeve të futbollit dhe të çdo aktiviteti tjetër sportiv që do të kryejë shoqëria në funksion të arritjes së qëllimit për të cilin është krijuar, duke respektuar njëkohsisht kushtet e vendosura për transmetim radio televiziv nga legjislativi në fuqi dhe rregullat e vendosura nga F.SH.F-ja për këto qëllime.
4. Për arritjen e qëllimit të sajë shoqëria mund të marrë dhe të japë pasuri të luejtshme dhe të pajetshme me qira ose në çdo formë tjetër përdorimi.
5. Kryerjen e aktiviteteve ekonomike që kanë të bëjnë me marketingun e së drejtës radio-televizive dhe atyre në fushën e reklamave, të menaxhimit të reklamave, të menaxhimit të lojtarëve brenda dhe jashtë vendit, duke respektuar rregullat e vendosura për këto qëllime nga F.SH.F-ja.
6. Blerje me qëllim shitjeje si dhe çdo veprimtari tjetër tregtare që është në pajtim me qëllimin e krijimit të shoqërisë si import-eksport dhe shitje të materialeve dhe artikujve sportive dhe atyre në funksion të terrave sportive.
7. Shoqëria për arritjen e qëllimit të sajë, kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme duke përfshirë edhe blerjen e aksioneve në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera.

### **Neni 5**



Selia e shoqerise eshte ne Kavaje ku do te ndodhet dhe drejtoria e saj, ne adresen: **Stadiumi "Besa", Lgj. Nr 2 Kavaje.**

#### **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqerise i perbehet nga kontributi ne te holla i aksionereve themelues te kesaj Shoqerie.

Kontributi ne para do te jete i perbre nga shuma 2.000.000 leke, qe eshte edhe vlere minimale e kapitalit themeltar per shoqerite pa oferte publike, shume e derdhur teresisht ne momentin e nenshkrimimit te kesaj kontrate themelimi nga aksioneret themelues te kesaj Shoqerie.

Ne kapitalin fillestar te shoqerise do te perfshihen edhe te gjitha investimet qe kane bere aksioneret themelues te kesaj shoqerie, si investime ne te holla ashtu edhe ne natyre, sipas percaktimit te bere ne Udhezimin e Ministrit te Financave nr.9, date. 12.09.2000. Percaktimi i vleres se tyre do te behet sipas rregullave qe percakton per kete qellim ligji "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne momentin e themelimit te shoqerise.

#### **Neni 7**

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 2 000 aksione me vlere nominale prej 1 000 leke.

Aksioneret themelues te Shoqerise Tregtare "S.K.BESA"Sh.a, zoterojne 100% te vleres se aksioneve ne kapitalin fillestar te Shoqerise te ndara si me poshte:

- |                               |            |
|-------------------------------|------------|
| <b>1. Z. ENGJELL BURIMI</b>   | <b>34%</b> |
| <b>2. Z. SHPETIM BIZHDILI</b> | <b>33%</b> |
| <b>3. BASHKIA KAVAJE</b>      | <b>33%</b> |

#### **Neni 8**

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asambleja e Aksionereve, e cila perfaqesohet nga aksioneret themelues te shoqerise, te cilet perfqesojne ne kete asamble vleren e pergjitheshme te aksioneve ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

#### **Neni 9**

##### **2. Drejtoria**

Drejtoria e Shoqerise perbehet nga nje anetar i vetem.

Drejtori emerohet per nje periudhe kohe te pakufizuar.

**Drejtori** i "S.K.BESA"Sh.a, do te jete **Z. Engjell Burimi**, i cili do te jete njekohesisht edhe **President i Klubit te Futbollit "Besa"**, i shendruar me vendim te Asambles se Jashtzakonshme ne Shoqerin Tregtare "S.K.Besa" Sh.a.

Drejtori i Shoqerise zgjidhet nga Kesjilli Mbikqyres, per periudhen kohore te shprehur si me siper.

#### **Neni 10**



Keshilli mbikqyres i Shoqerise perbehet nga tre anetare te cilet jane caktuar si me poshte:

1. Agron Qani HARIZI
2. Fatmir Osman EFICA
3. Islam Brahim VELIU

Kohezgjatja e anetareve te Keshillit Mbikqyres do te jete jo me shume se tre vjet.  
Ata kane te drejte te rizgjidhen.

#### Neni 11

Ekspertet kontabel te autorizuar te shoqerise do te emerohen ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe per c'do vit fianciar te ushtrimit te veprimatrise se shoqerise. Shoqeria do te kete nje ekspert kontabel. Eksperti i pare kontabel do te jete eksperti Elez LALA

#### Neni 12

Organizimi dhe funksionimi i shoqerise, ngritja e degeve apo filialeve te saja do te behet ne perputhje me dispozitat e statutit.

#### AKSIONERET THEMELUES

ENGJELL BURIMI

SHPETIM BIZHDILI

BASHKIA KAVAJE

*Engjell Burimi*  
*Shpetim Bizhdili*

